



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA MALLAKASTËR**  
**KRYETARI**

Nr. \_\_\_\_\_ Regj.

Ballsh, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2021

Lënda: **Formulari i Njoftimit të Fituesit**

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK - TIRANË**  
(për publikim në SPE dhe buletin e njoftimeve publike)

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**BASHKIA MALLAKASTËR**

Data 10.12.2021

Drejtuar: **“K.M.K” shpk**, me NIPT L78223801E, me adresë ushtrimi të aktivitetit sipas QKB:  
Bulevardi “Rrapo Hekali”, Shkalla 1, Kati 1, BALLSH

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e hapur e thjeshtuar”**

Numri i referencës së procedurës: **REF-11212-11-11-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i rrugës “Gani Malasi” Ballsh”**, me fond limit **2,750,621** (dymilion e shtatëqind e pesëdhjetëmijë e gjashtëqind e njëzetë e një) **lekë pa TVSH**, me afat 1 (një) muaj.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.163, datë 15 Nëntor 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim

**Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:**

1. **“6D - PLAN” shpk**, me NIPT L62717405H, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **2,096,271** (dymilion e nëntëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e një) **lekë pa TVSH**.
2. **“ARDMIR” shpk**, me NIPT K82509006P, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **2,428,995** (dymilion e katërqind e njëzetë e tetëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH**.

3. **“ASI-2A CO” shpk**, me NIPT K53002402C, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **2,747,080** (dymilion e shtatëqind e dyzet e shtatë mijë e tetëdhjetë) **lekë pa TVSH**.
4. **“AVDULI” shpk**, me NIPT J66703306O, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **2,201,190** (dymilion e dyqind e një mijë e njëqind e nëntëdhjetë) **lekë pa TVSH**.
5. **“BONUS” shpk**, me NIPT K72412009E, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **2,533,310** (dymilion e pesëqind e tridhjetë e tremijë e treqind e dhjetë) **lekë pa TVSH**.
6. **“GENERAL BETON” shpk**, me NIPT K23013401A, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **2,492,500** (dymilion e katërqind e nëntëdhjetë e dymijë e pesëqind) **lekë pa TVSH**.
7. **“GENTI 001” shpk**, me NIPT L93101401U, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **2,078,650** (dymilion e shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH**.
8. **“K.M.K” shpk**, me NIPT L78223801E, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **1,831,230** (një milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e dyqind e tridhjetë) **lekë pa TVSH**.
9. **“KADIA” shpk**, me NIPT J66703117R, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **2,190,754** (dymilion e njëqind e nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH**.
10. **“SARK” shpk**, me NIPT K52531415H, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **2,253,404** (dymilion e dyqind e pesëdhjetë e tremijë e katërqind e katër) **lekë pa TVSH**.
11. **“SHENDELLI” shpk**, me NIPT K07924803N, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **2,247,280** (dymilion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë) **lekë pa TVSH**.
12. **“VELLEZERIT KUKA” shpk**, me NIPT J63423440Q, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **2,439,300** (dymilion e katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e treqind) **lekë pa TVSH**.

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

**1. “6D - PLAN” shpk**, me NIPT L62717405H, **për arsyet e mëposhtme:**

- Formulari i Sigurimit të Ofertës nuk plotëson kushtin e periudhës së vlefshmërisë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë, siç është përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit. Formulari i Sigurimit të Ofertës që është paraqitur në SPE, është me periudhë vlefshmërie 30 (tridhjetë) ditë, gjë e cila nuk përmbush periudhën e vlefshmërisë së përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit dhe rrjedhimisht nga “6D-PLAN” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.
- Gjithashtu, është konstatuar se Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit nuk është i saktë në të gjitha aspektet. Te Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, në rubrikën B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura, pika 2, te Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit përcaktohet se: “2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;”.

Referuar të dhënave të plotësuara në pikat e mëposhtme të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konkretisht në pikën 4, “6D-PLAN” shpk, nuk ka konfirmuar me “PO”, por ka konfirmuar me “JO” se:

“4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;” - JO.

Sa më sipër, konstatohet se deklarata është e pasaktë në të gjitha aspektet dhe rrjedhimisht nga “6D-PLAN” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.

**2. “ASI-2A CO” shpk, me NIPT K53002402C, për arsyet e mëposhtme:**

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën “1/b”, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7 të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi nuk është paraqitur Formulari i Sigurimit të Ofertës dhe rrjedhimisht nga “ASI-2A CO” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.

**3. “BONUS” shpk, me NIPT K72412009E, për arsyet e mëposhtme:**

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën “1/b”, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7 të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi nuk është paraqitur Formulari i Sigurimit të Ofertës dhe rrjedhimisht nga “BONUS” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën “2.3.8.”, të kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7 të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi nuk janë paraqitur Certifikatat e kërkuara në këtë pikë dhe rrjedhimisht nga “BONUS” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.

**4. “GENTI 001” shpk, me NIPT L93101401U, për arsyet e mëposhtme:**

- Formulari i Sigurimit të Ofertës nuk plotëson kushtin e periudhës së vlefshmërisë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë, siç është përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit. Formulari i Sigurimit të Ofertës që është paraqitur në SPE, është me periudhë vlefshmërie 60 (gjashtëdhjetë) ditë, gjë e cila nuk përmbush periudhën e vlefshmërisë së përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit dhe rrjedhimisht nga “GENTI 001” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.

**5. “VELLEZERIT KUKA” shpk, me NIPT J63423440Q, për arsyet e mëposhtme:**

- Formulari i Sigurimit të Ofertës nuk plotëson kushtin e periudhës së vlefshmërisë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë, siç është përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit. Formulari i Sigurimit të Ofertës që është paraqitur në SPE, është me periudhë vlefshmërie 31 (tridhjetë e një) ditë, gjë e cila nuk përmbush periudhën e vlefshmërisë së përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit dhe rrjedhimisht nga “VELLEZERIT KUKA” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.

**6. “SARK” shpk, me NIPT K52531415H, për arsyet e mëposhtme:**

- “SARK” shpk skualifikohet nga kjo procedurë pasi është në kushtet detyruese për skualifikim, parashikuar nga neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”. Konkretisht, në pikën 3, gërma “dh”, të nenit 76, parashikohet se:

*“3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:*

*... dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;”*

Në interpretim të dispozitës së mësipërme, KVO i referohet procedurës së prokurimit me objekt “Blerje kontenierë për mbetjet urbane”, me numër reference REF-07189-10-05-2021, procedurë në të cilën “SARK” shpk është shpallur fitues, por është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës, pasi nuk ka paraqitur Formularin e Sigurimit të Kontratës brenda afatit të përcaktuar nga AK Bashkia Mallakastër.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: “**K.M.K**” **shpk**, me NIPT L78223801E, me adresë ushtrimi të aktivitetit sipas QKB: Bulevardi “Rrapo Hekali”, Shkalla 1, Kati 1, BALLSH, se oferta e paraqitur, me vlerë totale prej **1,831,230** (një milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e dyqind e tridhjetë) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109, të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Qerim Ismailaj**